



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 12 nëntor 2012

**Kremtimi i 10 vjetorit të Komisionit për parandalim të
korupsionit
(Pallata e Armatës)**

**Fjalim i
Sh. T. Z. Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE-së**

I nderuar kryetar i Komisionit shtetëror për parandalim të
korrupsionit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar koleg,
Zonja dhe zotëri,

Dua të falënderohem për ftesën për të festuar së bashku 10 vjetorin nga themelimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit.

Unë e përgëzoj Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit, i përshëndes anëtarët dhe personelin e saj dhe u dëshiroj çdo të mirë në punën e tyre të rëndësishme!

10 vjet për një institucion, si edhe për një qenie njerëzore – nuk është kohë e gjatë. Si edhe njerëzit ashtu edhe institucionet kanë nevojë për rritje, për pjekuri, për ta gjetur vendin në strukturën e komplikuar publike dhe sociale, për të fituar besimin e qytetarëve.

Megjithatë, krahas ekzistimit të shkurtër, Komisioni për anti-korrupsion ka arritur të arrijë shumë dhe meriton lëvdatë: ajo gradualisht e ka forcuar kornizën ligjore dhe institucionale, mos të përmendim edhe kulturën profesionale dhe institucionale.

Mekanizma parandalues për kontroll të pasurisë dhe interesat e zyrtarëve shtetëror është formuar dhe ka filluar të zbatohet në praktikë.

Bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë është krijuar me sukses dhe është zgjeruar më tej.

Ne gjithashtu kemi pasur bashkëpunim të suksesshëm me Komisionin për anti-korrupsion që nga themelimi i saj.

Dhe shpresojmë se do të vazhdoj ky bashkëpunim i suksesshëm në frymën e njëjtë !

Të nderuar zonja dhe zotëri,

Nga raportet e fundit të progresit të BE-së, mund të vërejmë se ata e pasqyrojnë zhvillimin e Komisionit shtetëror.

Është arritur progres në frontin e legjislacionit dhe atij institucional, me që janë miratuar ligje dhe dokumente politike dhe janë reformuar institucione që ka rezultuar me fuqi më të madhe për luftë kundër korrupsionit.

Iniciativat për E-Qeverisje dhe qeverisje e mençur i kanë ulur rastet e korrupsionit.

Janë organizuar trajnime dhe është ndërtuar partneritet me sektorin publik, OJQ-të dhe me sektorin afaristë.

Meritë më të madhe për këto aktivitete inkurajuese ka Komisioni për anti-korrupsion i cili ishte udhëheqës i këtyre zhvillimeve.

Puna e mirë krijon pritje, dhe jo vetëm për Komisionin shtetëror, por për tërë sferën e anti-korrupsionit.

Siç thekson Raporti i progresit dhe Dialogu në nivel të lartë, ekzistojnë përpjekje të qarta nga Komisioni për anti-korrupsion dhe nga organe të tjera relevante për plotësimin e këtyre pritjeve dhe për adresimin e sfidave të tjera në këtë sektor.

BE-ja pret që ky trend pozitiv për trajtimin serioz të politikave për anti-korrupsion do të vazhdoj dhe se do të shëndrohet në rezultate konkrete praktike në të ashtuquajturën “regjistrim i performancës” të parandalimit efikas dhe luftës kundër korrupsionit.

Të gjithë mund të pajtohemi se një regjistër i qëndrueshëm i performancës të zbulimit, hetimit dhe gjykimit të rasteve të

korrupsionit, përfshirë edhe raste të nivelit të lartë, është një vegël e fuqishme për parandalim, së bashku me kontrollin e brendshme të fuqishme dhe standarde për menaxhim të resurseve njerëzore, verifikim sistematik për deklaratave për pasuri dhe konflikte të interesit dhe aplikimi i sanksioneve. ,

Duke u dëshmuar qytetarëve se shteti ka vullnet por para se të gjithash është në gjendje ta parandaloj dhe luftoj korrupsionin, jo vetëm që do ta rris besimin e qytetarëve ndaj shtetit, por do të stimuloj ndryshime në sjelljen dhe "Zero tolerance për korrupsionin".

Zonja dhe zotëri,

Më lejoni të përfundoj duke theksuar se BE-ja do të vazhdoj me përkrahjen e plotë të vendit dhe popullsisë tuaj në plotësimin e dy qëllimeve kryesore – institucione efikase dhe të pavarura dhe Zero tolerancë për korrupsionin në shoqëri.

Për këtë arsye, vitin e ardhshëm ne do të shpallim disa projekte të mëdha të BE-së. Njëri do të përqendrohet në reformat aktuale të drejtësisë penale duke siguruar këshilla dhe pajisje bashkëkohore për vepruesit në sferën e drejtësisë penale.

Një tjetër projekt do të merret me shqyrtimin dhe modernizimin e politikave për anti-korrupsion dhe do të përfshin analiza, trajnime, zgjidhe juridike, institucionale dhe IT, mos të përmendim fushata për ngritjen e vetëdijes për të cilat gjithsesi do të dëgjoni.

Është kënaqësi që Komisioni do të jetë përfituesi kryesor i këtij projekti.

Dhe projekti i tretë do ti drejtohet forcimit të pavarësisë gjyqësore përmes ndërtimit të kapaciteteve, përkrahjes juridike dhe teknologjike.

Ne besojmë se këto tre projekte do të mundësojnë përparim të qëndrueshëm në sferën e gjyqësisë dhe anti-korrupsionit të cilat konsiderohen si sfera kryesore në rrugën drejtë anëtarësimit në BE.

Edhe një herë – e përuroj Komisionin shtetëror dhe e mirëpres bashkëpunimin tonë të ardhshëm!

Ju faleminderit për vëmendjen.